

HIMNI AKATHIST

**Botimet “Trifon Xhagjika”
Tiranë, 2016**

Përgatiti për botim: **Andrea Llukani**

PARATHËNIE

Mesazhi që përcjell Himni Akathist është lajmi i mirë i Mengjëllit tek Hyjlindësja Mari. Ndonëse krijuesi i Himnit Akathist ka mbetur i panjohur fuqia poetike e tij përbën një burim të pashtershëm shpirtëror për besimtarët ortodoksë. Le të shpjegojmë me pak fjalë historinë si u krijua ky himn. Perandoria Bizantine gjatë viteve mbretërimit të perandorit Irakli (610-641) njohu shumë armiq. Në lindje persët pushtuan Kapadokinë, Armeninë dhe Sirinë, ndërsa në vitin 614 rrethuan Jeruzalemin. Pas 20 ditë rrethimi, Jeruzalemi ra në duart e pushtuesve. Armiqtë filluan të grabisnin dhe të plaçkisnin gjithçka. Gjashtëdhjetë mijë të krishterë, u vranë duke luftuar. U grabitën të gjitha thesaret e çmuara të kishave dhe shumë të krishterë u zunë robër. Por, pushtuesit nuk u mjaftuan vetëm me kaq. Në ikje e sipër morën Kryqin e Nderuar të Krishtit, që gjendej në Jeruzalem. Kryqi i Nderuar, tashmë ishte në duart e paganëve, duke i marrë Perandorisë Bizantine thesarin më të çmuar. Por, edhe nga kufijtë veriorë rreziku ishte i madh. Në vitin 617 avarët e sllavët pushtuan shumë toka të Perandorisë Bizantine. Përballë kësaj gjendjeje të vështirë perandori Irakli, në vitin 619 i rënë në një pesimizëm të thellë donte të braktiste perandorinë. Në këto rrethana të vështira patriku Serxh, duke i dhënë kurajo perandorit Irakli shiti gjithë thesaret e kishave dhe me paratë e fituara përgatiti ushtrinë kundër armiqve të besimit. Me atë ndihmë të çmuar të kishës, u plotësuan nevojat e përgatitjes së ushtrisë dhe të flotës. Qëllimi i gjithë kombit ishte, që me çdo sakrificë duhej të rimerrnin Kryqin e Nderuar dhe njëkohësisht të çlironin robërit e krishterë dhe qytetin e Shenjtë të Jeruzalemit.

Në vitin 619 perandori Irakli bëri një marrëveshje paqeje me avarët. Vetë perandori u vu në krye të ushtrisë, në luftën kundër persve. Në ceremoninë zyrtare që u celebrua në kishën e Shën Sofisë, më 5 Prill 622, ditë që përkonte me të Hënën e Pashkës, u lutën më Zotin që ta mbështeste qytetin dhe bijtë e tij të mitur nën mbrojtjen e Hyjlindëses. Ndërsa perandori Irakli ndërmori beteja fitimtare në luftën ndaj persëve, një rrezik i madh e kërcënonte perandorinë. Avarët duke shkelur marrëveshjen e paqes, në vitin 626 e sulmuan Kostandinopojën nga toka e deti. Kryetari i tyre Kagani e refuzoi propozimin për paqe të bizantinëve. Të gjithë luteshin më Zotin, duke u përpjekur me ç'të mundnin për të mbrojtur qytetin. Patriku Serxh me ikonën e Hyjlindëses në duar frymëzoi të paktit, por heronj mbrojtës të qytetit. Të gjithë këkonin ndërmjetimet e Hyjlindëses. Ata e quajtën “Përlufteshës Gjenerale” në luftën e pabarabartë të tyre. Dyndjet e sulmeve avare u smbrapsën nga luftëtarët trima. Papritur, një furtunë e fortë i zhyti anijet armike në det. Kagani me turp liroi rrethimin dhe u largua me flotën e mbetur. Mrekullia që të gjithë e prisnin tashmë ishte bërë realitet. Hyjlindësja kishte shpëtuar qytetin. Banorët e Kostandinopojës, u grumbulluan në kishën e Shën Marisë në Vllahernë, ku në shenjë mirënjohjeje dhe shprestarie psalën pa u ulur himnin falenderues të Hyjlindëses që u bë atë natë. Përlufteshës Gjenerale, këngët mundëse/ Si falenderim që u shpërbleve prej tmerreve/ Qyteti yt po të përshkruan o Virgjëreshë/ Po sikundër ke fuqi të palëftuarshme/ Prej çfarëdo rreziqesh shpëtomë/ Sepse të thërres “Gëzohu o nuse e panusëruar”. Ky himn, së bashku me disa tropare të tjera, si dhe gjithë Përshëndetjet e Hyjlindëses që ishin bërë deri më atë kohë u quajtën “Himni Akathist” (sepse u psal në këmbë). Ky himn këndohet në pesë të premtet e Kreshmëve të Mëdha. Gjatë katër të premtëve të para të Kreshmës së Madhe, lexohet nga një stancë e “Përshëndetjeve”, ndërsa të premtën e pestë lexohen të gjitha.

“PËRSHËNDETJET”

E HYJLINDËSES

(me Pasdarkën e Vogël)

Prifti: I bekuar është Perëndia ynë, gjithnjë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Lexuesi: Amin.

Prifti: Lavdi më Ty, o Krisht Perëndia ynë, lavdi më Ty.

O Mbret qiellor, Ngushëllimtar, Shpirt i së vërtetës, që ndodhesh kudo dhe i mbush të gjitha, thesar i të mirave dhe dhurues jete; eja dhe qëndro ndër ne dhe pastrona nga çdo njollë dhe shpëto, o i Mirë, shpirtrat tanë.

Lexuesi: Amin.

Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshirona (3 herë).

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Trini e Tërëshenjtë, mëshirona; o Zot, falna mëkatet tona; o Zot i madh, ndjei paudhësitë tona; o i Shenjtë, vështro dhe shëro sëmundjet tona, për emrin tënd.

Mëshiro, o Zot. (3 herë)

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Ati ynë që je në qiejt, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote si në qiell ashtu edhe mbi dhe. Bukën tonë të përditëshme jepna neve sot; dhe falna fajet tona, sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë; dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

Prifti: Se jotja është mbretëria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit, e Birit dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Lexuesi: Amin. Mëshiro, o Zot (12 herë)

Ejani t'i falemi e t'i biem ndër këmbë Perëndisë, Mbretit tonë. Ejani t'i falemi e t'i biem ndër këmbë Krishtit, Perëndisë dhe Mbretit tonë.

Ejani t'i falemi e t'i biem ndër këmbë vetë Krishtit, Perëndisë dhe Mbretit tonë.

Psalmi 50

Përdëllemë, o Perëndi, sipas përdëllimit tënd të madh dhe sipas dhembshurive të tua të shumta, shuaje paudhësinë time. Lajmë krejt prej paudhësisë sime dhe pastromë prej mëkatit tim. Se unë e njoh paudhësinë time, dhe mëkati im është përpara meje kurdoherë. Te ti vetëm mëkatova dhe të keqen e bëra përpara teje, kështu që ti je i drejtë në fjalët e tua dhe i kthjellët në gjykimin tënd. Se ja, tek u zura në paudhësi, dhe në mëkat më lindi nëna ime. Se ja tek deshe të vërtetën; të

patreguarat dhe të fshehtat e urtësisë sate m' i tregove. Spërkatmë me hisop, dhe do të pastrohëm; lajmë dhe do të bëhem më i bardhë se dëbora. Bëmë të dëgjoj gëzim e ngazëllim; dhe do të gëzohen eshtrat e dobësuarat. Ktheje fytyrën tënde nga mëkatet e mia, dhe shuaji gjithë paudhësitë e mia. Krijë zemër të pastër tek unë, o Perëndi, dhe përtërit frymë të drejtë në thellësitë e zemrës sime. Mos më hidh larg fytyrës sate, dhe mos e hiq prej meje Shpirtin tënd të Shenjtë. Jepma përsëri ngazëllimin e shpëtimit tënd dhe forcomë me frymë sunduese. Do t' u mësoj të paudhëve rrugët e tua, dhe të pabesët do të kthehen tek Ti. Shpëtomë prej gjakrash, o Perëndi, Perëndia i shpëtimit tim, gjuha ime do të lavdërojë me gëzim drejtësinë tënde. O Zot, çel buzët e mia, dhe goja ime do të lëçitë lavdinë tënde. Se po të kisha dashur therore, do të kisha prurë; por Ty s' të pëlqejnë therore me djegie të plotë. Therore ndaj Perëndisë është shpirti i dërrmuar; zemrën e dërrmuar e të përulur Perëndia nuk do ta përbuzë. Bëji të mirë, o Zot, Sionit, sipas mirëdashjes sate; dhe le të ndërtohen muret e Jerusalemit. Atëherë do të të pëlqejnë therore drejtësie, dhurata dhe therore me djegie të plotë. Atëherë do të sjellin viçër mbi altarin tënd.

Psalmi 69

O Perëndi, ndihmës time vëri re, o Zot, shpejto të më ndihmësh. U marrofshin e u turpërofshin ata që shpirtin tim kërkojnë; Shpatullat kthefshin dhe me turp dhe u mbulofshin ata që të keqen time duan. Mbrapsht u kthefshin menjëherë të turpëruar ata që më thonë: Të lumtë, të lumtë. U ngazëllofshin e u dëfrefshin në ty të gjithë ata që të kërkojnë, o Perëndi, dhe ata që duan shpëtim prej teje, thënshin përgjithnjë: U madhëroftë Zoti. Dhe unë jam i varfër e nevojtar; o Perëndi, ndihmomë. Ti je ndihmësi im dhe çlirimtari im, o Zot; mos u vono.

Psalmi 142

OZot, dëgjo faljen time, vëri veshin lutjes sime sipas së vërtetës sate, dëgjomë sipas drejtësisë sate. Dhe mos hyr në gjyq me shërbëtorin tënd, se asnjë i gjallë nuk do të dalë i drejtë përpara teje. Se armiku ma ndoqi shpirtin, dhe ma rrëzoi jetën përdhe. Më vuri në vende të errëta, si të vdekurit prej kohe, shpirti m'u trishtua dhe zemra m'u trondit. Kujtova ditët e lashta, mendova gjithë veprat e tua, sillja ndërmend punët e duarve të tua. I shtriva duart drejt teje; shpirti im ka etje për ty si toka e thatë. Dëgjomë shpejt, o Zot, m'u zu fryma. Mos e kthe mënjane fytyrën tënde prej meje, që të mos bëhem si ata që zbritën në varr. Bëj që të dëgjoj në përdëllimin tënd në mëngjes, se më ty shpresova. Tregomë, o Zot, udhën ku duhet të eci, se më ty e kam varur shpirtin. Shpëtomë prej armiqve të mi, o Zot, se tek ti kërkova strehë. Mësomë të bëj dëshirën tënde, se ti je Perëndia im. Fryma jote e mirë, do të më udhëheqë në vend të drejtë. Për emrin tënd, o Zot, gjallëromë. Sipas drejtësisë sate nxirr shpirtin tim nga trishtimi, dhe sipas mëshirës sate shfarosi armiqtë e mi, dhe shkatërroi të gjithë ata që hidhërojnë shpirtin tim se unë jam shërbëtori yt.

DHOKSOLOGJIA E VOGËL

Lavdi Perëndisë që është në më të lartat dhe mbi dhenë paqe,
dhe mbi njerëzit mirëdashje.

Të himnojmë, të bekojmë, të falemi, të lavdërojmë, Ty të
falenderojmë për lavdinë tënde të madhe.

Zot mbret, Perëndi qiellor, Atë i tërëfuqishëm; Zot Bir i
vetëmlindur Jisu Krisht, edhe Shpirt i Shenjtë.

Zot Perëndi, qengj i Perëndisë, Bir i Atit që ngre mëkatën e botës, mëshirona, Ti që ngre mëkatet e botës.

Prano lutjen tonë, Ti që rri në të djathtë të Atit, edhe mëshirona.

Se Ti je Shenjt i vetëm, Ti je Zot i vetëm, Jisu Krishti, për lavdi të Perëndisë Atit. Amin.

Për mbrëmje do të të bekoj, dhe do të lavdëroj emrin tënd për jetë, e në jetë të jetës.

OZot u bëre streha jonë brez pas brezi, unë thashë: O Zot, mëshiromë, shëro shpirtin tim se fajtova tek Ti.

OZot, tek Ti gjeta strehë, mësomë të bëj dëshirën tënde se Ti je Perëndia im.

Se pranë teje është burimi i jetës; me dritën tënde do të shohim dritë.

Zgjate përdëllimin tënd mbi ata që të njohin.

Bëna të denjë, o Zot, që të ruhemi këtë natë pa ndonjë mëkat.

Ibekuar je, o Zot, Perëndi i Etërvë tanë, dhe emri yt është i lëvduar dhe i lavdëruar në jetët. Amin.

Le të jetë, o Zot, përdëllimi yt mbi ne, sikurse kemi shpresuar tek Ti.

I bekuar je, o Zot, mësomë porositë e tua. I bekuar je, o Zot, Ibëmë të mençëm në porositë e tua.

I bekuar je, o i Shenjtë, ndriçomë me porositë e Tua.

O Zot, mëshira jote është përjetë, mos i hiq sytë nga veprat e duarve të Tua.

Ty të ka hije lëvdata, Ty të ka hije himni, Ty të ka hije lavdia, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

SIMBOLI I BESIMIT

Besoje në një Perëndi, Atë të tërëfuqishëm, krijues të qiellit dhe të dheut dhe të gjithë të dukurave dhe të padukurave. Dhe në një Zot, Jisu Krishtin, Birin e Perëndisë, të vetëmlindurin, që lindi prej Atit përpara gjithë shekujve. Dritë prej drite, Perëndi të vërtetë, prej Perëndie të vërtetë, të lindur, jo të bërë, që ka të qenët një me Atin, me anën e të cilit u bënë të gjitha. Që për ne njerëzit dhe për shpëtimin tonë, zbriti prej qiejve, dhe u trupëzua prej Shpirtit të Shenjtë dhe Virgjëreshës Mari dhe u bë njeri. Dhe u kryqëzua për ne në kohën e Pontit Pilat, dhe pësoi e u varros. Dhe u ngjall të tretën ditë sipas Shkrimeve. Dhe u ngjiti në qiejt dhe rri në të djathtë të Atit. Dhe do të vijë përsëri me lavdi të gjykojë të gjallët dhe të vdekurit, mbretëria e të cilit nuk do të ketë mbarim. Dhe në Shpirtin e Shenjtë, Zot, jetëbërës, që buron prej Atit, që adhurohet e lavdërohet bashkë me Atin e me Birin, që foli me anën e profetëve. Në një Kishë të Shenjtë, të përgjithshme dhe apostolike, Pohoj një pagëzim për ndjesën e mëkateve. Pres ngjalljen e të vdekurve. Dhe jetën e ardhshme të amëshuar. Amin.

Ti meriton me të vërtetë të të lumërojmë ty Hyjlindësen, gjithmonë të lumurën dhe të përmbikulluarën dhe Mëmën e Perëndisë tonë. Më të nderuarën se Keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cënuar linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindëse, ty të madhërojmë.

Tingull T. IV.
To Prostakthen.

Si mori vesh porosinë e mistershme, vajti te tenda e Josifit i Sxnituar Kryeengjëlli t'i thotë Virgjëreshës: Ai i cili qiejt përkuli kur zbriti këtu, mbahet i tëri pa ndryshuar fare tek Ti, që si e shoh në pëqirin tënd të marrë formë robi, çuditë edhe të thërres: Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

KANUNI I AKATHISTIT

Krijim i Josif Himnografit

Tingull IV.
ODA I. Anikso To Stoma Mu
Irmosi.

Ja gojën e çel tani, i frymëzuar prej Shpirtit të Shenjt, dhe këngë do t'i këndoj, Nënës së Madhe mbi fron, dhe do ta kremtoj, me valle buzëqeshur, me zë do t'i shpall kudo, gjithë çudit'e saj. (2 herë)

Troparet
E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Si libër të Zotit Krisht, të hirësuar prej Shpirtit të Shenjt, të Spa Kryeengjëlli, Mari Hyjlindëse, dhe të tha kështu: Lum' ti që sjell gëzimin; mallkimin stërgjyshëror, ti do ta zhdukësh krejt.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Adamin e ngrite lart, o Virgjëreshë Hyjlindëse, dhe Ferrin e Ashtrin përdhe, o Zonj' e Shenjtë Mari, lum' ti o pallat, i Zotit edhe Mbretit, lum' ti o i zjarri fron, i perandorit Krisht.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Gëzohu o lindëse e të pafishkurit trëndafil, gëzohu se ti po Grrit, mollën e herëshme, lule e qellëshme, e Zotit edhe Mbretit, lum' ti o Hyjlindëse, zonjë shpëtonjëse.

Tani e përherë e nëjetë të jetëve. Amin.

Thesar i virtytave, që na ke ngritur prej varreve, edhe prej Kufomave, Zonjë Hyjlindëse, lule dhe zambak, aromë për besnikët, temjam i mirerëshme, myrr' e paçmuarshme.

ODA III. **Tus sus immologus.**

Irmosi.

OZonjë dhe Nën' e Perëndisë, burim i pasosur jetësor, ti siguroi gjith' ata, që të këndojnë plot me zell, dhe lart në qell ku mbretëron, kurorëzoji me çdo lavdi. (2 herë)

Troparet.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Kallinë qiellor ti na ke mbirë, si arë pa buj' dhe pa lërim, lum' ti altar i shpirtëshme, ku buk' e jetës na u vu, lum' ti burim i ujëve, që japin jetë Hyjlindëse.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Mëshqerrë që demin na ke lindur, qellor për besnikët pa
Mcënim, lum' ti o del' e hyjëshme, se qengjin Perëndi na
dhe, mëkatin botëror që ngre, gëzohu Zonjë ndërmjetëse.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Gëzohu mëngjes i ditës sonë, që Diellin solle Jisu Krisht,
për botën dritë dhe për ne, dhe errësirë s'le mbi dhe, dhe
Ferrin e demonëve, e shkatërrove për gjithënjë.

Tani e përherë e nëjetë të jetëve. Amin.

Gëzohu o derë shpëtimtare ku Fjala dhe Bir, i vetëm shkoj,
Ferrit ia theve dyertë, me lindjen e çlironjësit, gëzohu port'
e hyjëshme, dhe shpëtimtare e ndritëshme.

ODA IV. **O kathimenos en dhoksi.**

Irmosi.

Ti që rri midis lavdisë, përmbi fronin e hyjëshme, nga një re
e lehtë, ardhe o Jisu i përjetëshëm, dhe na shpëtove me
dorën jetëdhënëse, të thërresim pra: Nder dhe lavdi gjithënjë
mbi ty.

Troparet

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Me këndime dhe me besë, të thërresim Hyjlindëse, lum' ti
mal i Shenjtë, që u hijesove prej Shpirtit Shenjt, lum' ti
kandil edhe shtamë manapurëse, që i ëmbëlson, ndjenjat e gjithë
besnikëve.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Mëshironjëse e botës, Virgjëreshë Hyjlindëse, lum' ti shkall
Me shenjtë, që nga dheu shpie në qell me hir, lum' ti o urë
që prier lavdëronjësit, që prej varreve, lart në Parajsën e
engjëjve.

Troparet.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Më e lartë prej çdo qelli, Shpëtimtarin e njerëzve, ti në
Mgjin' e shenjtë, e ke mbajtur Zonjë Hyjlindëse, lum' ti që
ngjeve me gjakun robën ndritëse, dhe shkëlqenjëse, të
Komandantit të Forcave.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Ligjëvënësin ke lindur, Virgjëreshë Hyjlindëse, që paligjësitë,
Lua fal të gjithëve darovisht; o lartësi pa kufi o thellësi pa
fund, ndërmjetonjëse, ti na ke ngritur në qiellin.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Ty që mplekse për njerinë, një kurorë të qiellshme, ty të
përhimnojme, lum' ti Virgjëreshë Hyjlindëse, lum' ti fortesë
dhe mbrojtje e të gjithëve, o përkrahëse, streh' e përikj' e
besnikëve.

ODA V. Eksesti ta simbanta

Irmosi.

Të gjith' i habite ti, me një çudi dhe një lavdi: Ti o Virgjëresh'
e pamartuar, Zotin e botës që mbretëron lart në qell, si një
bir e mbajte në pëqi, dhe shpëtim që lartazi, u dhurove besnikëve.

Troparet.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

OZonjë Hyjlindëse, që linde udhëheqësin, ti na ke shpëtuar nga përmbytja, ne mëkatarët dhe të pavyerit, Nus' e Perëndisë Shën Mari, lum' ti o Hyjpritëse, Nën' e Zotit të gjithave.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Kështjella e njerëzve, gëzohu o Hyjlindëse, vënd' i shenjtërimin dhe lavdisë, vdekja e Ferrit o Nus' e ndritëshme, o gëzim i engjëjve në qell, lum' ti o përkrahëse, e të gjithë besnikëve.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Ofron që shkëlqen dhe ndrit, me Fjalën e përjetëshme, lum, ti o Parajsë shpirtërore, që ke në qendër Zotin e jetëve, që i ëmbëlson edhe i ngjall, gjithë të gëzuarit, me kungatën e qellëshme.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Prej teje forcohemi, thërresim pra me zë të madh: Lum' ti o qytet i Mbretit tonë, e lavdëruar prej gjithë brezave, dhe prej gjithë kishave kudo, mal i lartë gjer në qell, det pa fund edhe pa kufi.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Pallat i djamanteve, të çmuar o Hyjlindëse, ti që na dhuron margaritarin, Fjalën e Atit dhe Shpëtimtarin ton' Krisht, ti me Perëndinë i pajton, gjithë lumëronjësit, që të lusin besnikërisht.

ODA VI. **Tin thian taftin.**

Irmosi.

Këtë të kremte e lusim sot, për Zonjën edhe Nënë
Hyjlindëse, gjithë hyjmëndësit; ejani trokisni pra duartë,
dhe lavdëroni Zotin që lindi prej asaj. (2 herë)

Troparet.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Banes' e Fjalës e ndritëshme, gëzohu shenjtërim i të gjithëve,
Zonjë Hyjlindëse, mburrur prej gjithë Profetëve dhe prej
të gjith' Apostujve dhe Shenjtorëve.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Na prure vesën e qiellshme, që shoji tërë zjarrin pagan të
keq: Ty të thërresim pra: Lum' ti o lesi i vesëve, që
Gjedeoni e pa, Zonjë Hyjlindëse.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Gëzohu Zonjë Hyjlindëse, liman u bëj për ne lundëronjësit,
ku të përmlidhemi, brenda në detin e helmeve, dhe të
përbalim sulmet e të paudhëve.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Gëzona Zonjë gëzonjëse, mendimet që të themi me zë të
madh: Lum' ti Hyjlindëse, re edhe ferrë e ndritëshme, që
ne besnikët na mbron dhe na mbulon gjithnjë.

ODA VII. Uk elatrefsan.

Irmosi.

Nuk u faleshin, krijesave hyjmëndësit, po Kryetarit lart, dhe kërcënimin me zjarr, e shkelën me trimëri, psalnin me brohori: Zot lavdi më ty, o Perëndi i Etërve, ti je vetëm i bekuar.

Troparet.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

O Hyjlindëse, gëzohu fron i shpirtëshme, o vreshtë plot hardhi, ngarkuar me rrush të kuq, zambak i pafishkur krejt, që lulëzon o Zonj', pra gëzohu ti, që shpirtet e besnikëve, i gëzon me gjak të Krishtit.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Ti që linde mjek, shëronjës të besnikëve, Mari Hyjlindëse, o shkop i shenjtë mistik, që lulen e qiellshme, ti lulëzon tani, Zonj' e ndritëshme, me gaz prej teje mbushemi, edhe jetë trashëgojmë.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Asnjë gjuhë s' mund, të lavdërojë vlerësisht, ty o Hyjlindëse; Anga Serafimet më lart, u ngrite kur linde ti, Mbretin Jisu Shpëtimtar; pra ati iu lut, të na shpëtojë gjithënjë, sa të lusim plot me besë.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Prej gjith' anëve, të lumërojm' Hyjlindëse, me thirrje gjithënjë. Gëzohu o Shën Mari, që mban në pëqirin tënd, Fjalën dhe

Zotin Krisht; pra ati iu lut, në librin e të gjallëve, të na shkruajë o Zonjë.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Ty të lutemi, të gjithë dhe përgjunjemi, me gjithë zemër' e shpirt; dëgjona pra Shën Mari, shpëtona prej helmeve, se po përmysemi, edhe ruaje, qytetin tënd Hyjlindëse, prej armiqve të pabesë.

ODA VIII. **Pedhas evagjis en ti kamino.**

Irmosi.

Djemat e dënuar për të djegur, prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit Krisht, si simbol në vjetëri, dhe si një veprim tani, dhe tërë botën po e mbledh për këng' e lavdërim: Himnojeni ju veprat e Zotit, dhe e lartësoni përmbi të gjithë jetët.

Troparet.

E përmbishenj të Hyjlindëse shpëtona.

Fjalën Jisu Krisht në krah' e prite, atë që mban gjithësinë ti e mban në gji, ti me qumësht e ushqen, Zotin dhe ushqenjësini, e dheut dhe të qiellit dhe të këndonjësve: Himnojeni ju veprat e Zotit, dhe e lartësoni përmbi të gjithë jetët.

E përmbishenj të Hyjlindëse shpëtona.

Ferrën e nxoniti Moisiu, dhe lindjen e Virgjëreshës na e mori vesh. Shëmbëlla e djemave, na e shfaqti qartazi: Në mes të zjarrit hidheshin edhe nuk digjeshin, Hyjlindëse Mari Virgjëreshë; ty pra të himnojme përherë dhe për jetë.

E përmbishenj të Hyjlindëse shpëtona.

Grackat e demonëve na zhveshën, po ti përsëri stolin e re
na veshe ne, kur na linde Zotin Krisht, edhe të verbuarit,
nga hija e mëkateve e panë Diellin, Hyjlindëse banesa e dritës,
ty pra të himnojmë përherë dhe për jetë.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Ngjallen dhe të vdekurit prej teje, se jetën dhe jetëdhënësin
e linde ti, flasin gjuhëlidhurit, shohin të verbuarit, shërohen
të lebrozurit dhe të lënguarit, dhe zhduken krejt nga drita
demonët, Zonjë Virgjëreshë shpëtim i njerëzisë.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Ti që na dhurove Shpëtimtarin, dhe ti që na lartësove gjer në
qiellin, lum' ti o Hyjlindëse, rojtëse shpëtonjëse, se ti i mbron
dhe i bekon gjithë këndonjësit: Himnojeni ju veprat e Zotit,
dhe e lartësoni përherë dhe për jetë.

ODA IX. Apas gjigjenis.

Irmosi.

Gjithë njerëzit, kërcenin me ngazëllim, tek drit' e Shpirtit
Shenjt, ejani lavdërojeni, engjëj në qiell ejani kremtojeni,
këtë të shenjtë panair të Kryezonjës Mari, dhe thërrisni: Ti je
më e lumura, Virgjëresh' e kulluar Hyjlindëse.

Troparet.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Cdo besnik thërret: Gëzohu Hyjlindëse, se gjithënjë na jep,
gaz që fare nuk mbaron, ti pra shpëtona prej gjithë ngasjeve,
nga sulmet e barbarëve dhe gjithë plagëve, që na vijnë, nga
shumic' e fajeve, dhe mëkateve tona të tmerrëshme.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Ardhe për ndriçim, për mbrojtje dhe për shpëtim, pra të Athërresim sot: Lum' o yll pa perëndim, që sjell në botë Jisunë diellin; lum' o hapëse e mbretërisë, kollon' e zjarrt' shum' e fort', që u shpie njerëzve një jet' të re, qiellore e që kurrë nuk ka mbarim.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Ejani besërisht, në Kishën e Zotit Krisht, dhe përshëndoseni, Nënë dhe Hyjlindësen: O Virgjëreshë Zonj' e të gjithëve, lum' ti më e bekuara në mes të grave mbi dhë, lum' ti lule, myrrën e përbotëshme, ti e prite në gjirin dhe na e dhe.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Lum' ti o pëllumb, se ti mëshironjës in, na prure përmbi dhe, Lmburrj' e Oshënarëve, edhe kurora e Athloforëve, dhe e Dëshmorëve dhe e Shenjtorëve, zbukurimi i gjith' të krishterëve, dhe shpëtimi i gjithë besnikëve.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Zot dhe Perëndi, kurse trashëgimin tënd, falu besnikëve, Zndjesën e mëkateve, dëgjoja lutjet Nënës Hyjlindëse, dhe ndërmjetimet pa pushim për gjithë njerëzit, dhe shpëtoji, sipas përdëllimit tënd, edhe falna Parajsën e qiellit.

Tingull T. IV. E vetëzëshme.
Ti ipermako.

Përlufteshës gjenerale këngët mundëse, si përhirim që e shpëtove prej tmerreve, qyteti yt po të përshkruan, o Virgjëreshë. Po sikurse ke fuqi të paluftuarshme, prej çfarëdo rreziku shpëtomë, se po të thërres: Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

Gjatë katër të premteve të para të Kreshmës së Madhe, lexohet nga një stancë e “Përshëndetjeve”, ndërsa të premten e pestë lexohen të gjitha.

STANCA E PARË

Prifti duke qëndruar para ikonës së Hyjlindëses lëçit Stancën e Parë të “Përshëndetjeve”.

Engjëlli kryetar u dërgua nga qielli t’i thotë Hyjlindëses: Gëzohu (3 herë); dhe duke të parë të trupëzohesh, o Zot, bashkë me zërin engjëllor, çuditej e qëndronte duke i thirrur asaj kështu:

Gëzohu ti, me anën e së cilës do të shkëlqejë gazi; gëzohu ti, me anën e së cilës do të humbasë mallkimi.

Gëzohu, o rithirje e Adamit të rënë; gëzohu, o shpërblim i lotëve të Evës.

Gëzohu, o lartësi, ku mendjet njerëzore nuk arrijnë të ngjiten dot; gëzohu, o thellësi, ku dhe sytë engjëllorë e kanë të vështirë të shikojnë.

Gëzohu, se Ti je froni i Mbretit; gëzohu, se Ti mban atë që i mban të gjitha.

Gëzohu, o yll, që tregon diellin; gëzohu, o bark që trupëzon hyjninë.

Gëzohu Ti, me anën e së cilës përtërihet krijesa; gëzohu Ti, me anën e së cilës foshnjëzohet Krijuesi.

Gëzohu, u Nuse e panusëruar.

Priifti temjanis ikonën e Hyjlindëses, ndërsa psaltët:

Gëzohu, u Nuse e panusëruar.

Duke parë e Shenjta veten e saj të kulluar, i thotë Gavrilit me guxim: Lajmi i çuditshëm i duket shpirtit tim i pabesueshëm; se, si flet për shtatëzani nga një ngjizje e pafarshme? Edhe thërret:

Alilua.

Duke dashur të njohë të panjohurën, Virgjëresha i thirri meshtarit: Si mund të lindet një bir prej gjiri të kulluar? Thuamë. Dhe ai i tha asaj me frikë, duke thirrur kështu:

Gëzohu, o njohëse e misterit të vullnetit të fshehtë; gëzohu, o besim i heshtjes së atyre që falen.

Gëzohu, o preludi i mrekullive të Krishtit; gëzohu, o kreu i doktrinave të tij.

Gëzohu, o shkallë qiellore, me anën e së cilës zbriti Perëndia; gëzohu, o urë që çon njerëzit nga toka në qiell.

Gëzohu, o çudi e famshme e engjëjve; gëzohu o plagë e shumëvajtueshme e demonëve.

Gëzohu Ti, që në mënyrë të patreguar linde dritën; gëzohu Ti, që nuk i the askujt se si.

Gëzohu Ti, që kapërcen dijen e të urtëve; gëzohu Ti, që ndriçon mendjet e besimtarëve.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

Fuqia e të Shumëlartit e hijesoi atëherë të Pamartuarën që të ngjizet dhe barkun e saj të frytshëm, si arë ua tregoi të gjithë atyre që duan të korrin shpëtim, duke psalur kështu:

Alilua.

Duke patur mitrën hyjpritëse, Virgjëresha nxitoi tek Elisabeta; dhe foshnja e saj, duke kuptuar menjëherë përshëndetjen e saj, gëzohej; dhe me kërcime, si me këngë, i thërriste Hyjlindëses:

Gëzohu, o hardhi prej lastari që nuk fishket; gëzohu, o arë fruti të përjetshëm.

Gëzohu Ti, që kultivon bujkun njeridashës; gëzohu Ti, që mbin mbjellësin e jetës sonë.

Gëzohu, o arë, që nxjerr pjellori mëshirash; gëzohu, o tryezë, që mban bollëk dhembshurish.

Gëzohu, se lulëzon livadhin e dëfrimit; gëzohu, se përgatit limanin e shpirtrave.

Gëzohu, o temjam i mirëpritur ndërmjetimi; gëzohu, o ndjesë e gjithë Botës.

Gëzohu, o mirëdashje e Perëndisë për njerëzit; gëzohu, o guxim i njerëzve përpara Perëndisë.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

Duke patur përbrenda turbullim mendimesh të dyshimta, Josifi i urtë u shqetësua duke të parë të pamartuar e duke të kujtuar martesë-vjedhëse, o e Paqortueshme; po kur mësoi për ngjizjen tënde nga Shpirti i Shenjtë, tha:

Aliluia.

Tingull. T.IV.

Ti ipermaho stratigo.

Përlufteshës gjenerale këngët mundëse, si përhirim që e shpëtove prej tmerreve, qyteti yt po të përshkruan, o Virgjëreshë. Po sikurse ke fuqi të paluftuarshme, prej çfarëdo rreziku shpëtomë, se po të thërres:

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

Lexuesi: Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshirona. (3 herë)

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Trini e Tërëshenjtë, mëshirona; o Zot, falna mëkatet tona; o Zot i madh, ndjei paudhësitë tona; o i Shenjtë, vështro dhe shëro sëmundjet tona, për emrin tënd.

Mëshiro, o Zot (3 herë).

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Ati ynë që je në qiejt, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote si në qiell ashtu edhe mbi dhe. Bukën tonë të përditëshme jepna neve sot; dhe falna fajet tona, sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë; dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

Prifti: Se jotja është mbretëria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit, e Birit dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Lexuesi: Amin.

Përlufteshës gjenerale këngët mundëse, si përhirim që e shpëtove prej tmerreve, qyteti yt po të përshkruan, o Virgjëreshë. Po sikurse ke fuqi të paluftuarshme, prej çfarëdo rreziku shpëtomë, se po të thërres: Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

Mëshiro, o Zot. *(40 herë)*

OKrisht, Perëndi që adhurohesh e lavdërohesh në çdo kohë e në çdo orë në qiell e mbi dhe, zemërgjerë, zemërdhembshur, mëshirëplotë, që do të drejtët dhe mëshiron mëkatarët, që i thërret të gjithë në shpëtim me zotimin e të mirave të pritme, ti o Zot, prit lutjet tona në këtë orë dhe drejto jetesën tonë sipas porosive të tua. Shenjtërona shpirtrat, pastrona trupat, ndreqna mendimet, pastrona mendjet dhe shpëtona prej çdo hidhërimi, të keqeje dhe helmi. Mbrona me engjëjt e tu të shenjtë që duke u ruajtur dhe duke u udhëhequr prej ushtrisë së tyre të arrijmë të baresim tek bashkimi i besës

dhe tek njohja e lavdisë sate të paafruar, se i bekuar je në jetë të jetëve. Amin.

Mëshiro, o Zot. (3 herë)

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Më të nderuarën se Keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cënuar linde fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindëse, ty të madhërojmë.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot. (3 herë). Beko, o Atë me emrin e Zotit.

Prifti: Perëndia na mëshiroftë dhe na bekoftë, na tregoftë dritën e fytyrës së vetë dhe na shpëtoftë.

Lexuesi: Amin. Mëshiro, o Zot. (3 herë)

Urata e të Tërëshenjtës

Prej Pavlit, murgut të Manastirit të Evergjetit.

Epapikëlluar, e papërlyer, e pacënuar, e panjollshme, Virgjëreshë e pastër, Zonjë Nuse e Perëndisë, që bashkove Fjalën Perëndi me njerëzit me lindjen tënde të çuditshme dhe mbështete natyrën e hedhur të gjinisë sonë me qielloret; e vetmja shpresë e të dëshpëruarve dhe ndihma e të luftuarve; përkrahja e gatshme e atyre që rendin tek ti dhe strehë e gjithë të krishterëve; mos të ardhhtë ndot nga unë mëkatari, i mallkuari, që prisha tërë veten time me mendime, fjalë dhe vepra të turpshme dhe që u bëra rob me dashje nga plogështia mendore e dëfrimeve të jetës; por si Nënë e Perëndisë njeridashës, me

dashmirësi le të të vijë keq për mua mëkatarin dhe plangprishësin, dhe prit lutjen që të blatohet prej buzësh të ndotura; dhe lutju Birit tënd dhe mbretit e Zotit tonë, duke përdorur guximin tënd prej nëne që të ma hapë dhe mua zemrën njeridashëse të mirësisë së tij; dhe, duke mos vënë re fajet e mia të panumërta, të më kthejë në pendim dhe të më bëjë punëtor të sprovuar të porosive të tij. Dhe ji pranë meje gjithnjë, si mëshirëplotë, simpatike, dhe mirë-dashëse; në këtë jetë mbrojtëse dhe ndihmëse e nxehtë, duke thyer sulmet e kundërshtarëve dhe duke më udhëhequr drejt shpëtimit; dhe në kohë të ikjes sime, duke u kujdesur për shpirtin tim të mjerë dhe duke dëbuar larg faqet e errëta të demonëve të ligj; dhe në ditën e frikshme të gjyqit shpëtomë nga Ferri i amëshuar dhe tregomë trashëgimtar të lavdisë së patregueshme të Birit tënd dhe Perëndisë tonë; të Cilin e paça, o Zonja ime, Hyj lindëse e Përbishenjtë, me ndërmjetimin dhe përkrahjen tënde me hirin dhe njeridashjen e Birit tënd të vetëmlindur, Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Jisu Krishtit; të Cilit i përket çdo lavdi, nder e adhurim, bashkë me Atin e tij të pafillim dhe Shpirtin e tij të Tërëshenjtë, të mirë e jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Urata e Krishtit

Prej Antiokut, murgut të Pandektit.

Dhe jepna, o Zot, neve që shkojmë për gjumë, prehje trupi dhe shpirti: dhe ruajna nga gjumi i errët i mëkatit dhe prej çdo dëshire të errët e të natshme. Pusho hovet e pasioneve, shuaji shigjetat e zjarrta të të ligut që lëvizin kundër nesh dinakërisht; thyjei kryengritjet e trupit tonë dhe vër në gjumë çdo mendim tokësor e lëndor. Dhe dhurona, o Perëndi, mendje vigjëluese, mendim të urtë, zemër esëll, gjumë të lehtë dhe pa ndonjë fantazi satanike. Dhe zgjona në kohë të faljes, të

mbështetur në porositë e tua duke pasur me veten tonë kujtimin e pathyer të gjykimeve të tua. Falna lavdërimin tënd tërë natën, që të himnojmë, të bekojmë e të lavdërojmë emrin tënd të gjithënderuar e madhështor, të Atit e të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Epërmbilavdëruar, gjithmonëvirgjër, e bekuar Hyjlindëse, dërgoja faljen tonë Birit tënd dhe Perëndisë tonë dhe lypi që të shpëtojë me anën tënde shpirtrat tanë.

Shpresa ime është Ati; streha ime është Biri; mbrojtja ime është Shpirt i Shenjtë; Trini e Shenjtë, lavdi më Ty.

Gjithë shpresën time e vë tek ti o nënë e Perëndisë; ruajmë nën mbrojtjen tënde.

Prifti: Lavdi më Ty, o Krisht Perëndi, shpresa jonë, lavdi më Ty.

Lexuesi: Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin. Mëshiro, o Zot. (3 herë) Beko, o Atë i shenjtë.

Prifti: Krishti Perëndia ynë i vërtetë, me ndërmjetimet e Nënës së Tij të pacënuar dhe krejt të papërlyer, të nderuarit, të lavdëruarit Profet, Pararendësit dhe Pagëzorit Joan; të Apostujve të shenjtë, të lavdëruar e të dëgjuar; të Martirëve të shenjtë, të lavdëruar dhe mundës të shkëlqyer; të Etërve tanë oshënarë dhe hyjprurës; (të shenjtit të Kishës) të Hyjprindërve të shenjtë e të drejtë Joakim dhe Ana, të shenjtit (të ditës) që lusim sot dhe të gjithë shenjtorëve, na mëshiroftë dhe na shpëtoftë si Perëndi i mirë, njeridashës dhe mëshirues.

Prifti: Le të lutemi për paqen e botës.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për të krishterët besëmirë dhe orthodhoksë.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për Kryepiskopin tonë (*aksh*) dhe për tërë vëllazërinë tonë më Krishtin.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për etërit dhe vëllezërit tanë të jetëndërruar.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për ata që na shërbejnë dhe për ata që na kanë shërbyer.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për ata që na urrejnë dhe për ata që na duan.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për ata që na porositën ne të pavyerit të lutemi për ta.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për çlirimin e robërve.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për mirëlundronjësit e deteve.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për të dergjurit në sëmundje.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për plotësinë e pemëve të dheut.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për të gjithë të krishterët orthodhoksë, që prehen me shpresë këtu e kudo.

Lexuesi: I përjetshëm qoftë kujtimi i tyre.

Prifti: Le të themi dhe për veten tonë.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot. (3 herë)

Tingull. III. **Tin Oreotita.**

O bukuri me nam, o virgjëri pa cen, o drit' e diellit, o hën' e qiellit. Shën Gavrieli kur të pa, çuditej dhe të thërriste: Si të të lavdëroj, o Mari Hyjlindëse. Ç'këngë të këndoj për Ty, nuk e di dhe kërkoj më kot. Pra them sikundër jam porositur: Gëzohu, Virgjëreshë Hirplotë.

Prifti: Me uratat e Etërve tanë të shenjtë, o Zot Jisu Krisht Perëndi, mëshirona dhe shpëtona.

Psaltët: Amin.

STANCA E DYTË

Në të Premten e dytë të Kreshmëve në mbrëmje celebropet Pasdarka e Vogël. Pas "Ti Meriton" psalet Kanoni i Hyjlindëses dhe Shkurtorja "Përlufteshës Gjenerale". Në vijim prifti lëçit Stancën e Dytë të "Përhëndetjeve".

Barinjtë dëgjuan engjëjt që himnonin ardhjen trupësore të Krishtit, dhe, duke rendur si tek një bari, e panë si qengj të panjollë, të kullotur në barkun e Marisë, të cilës, duke himnuar i thanë:

Gëzohu o Nënë qengji dhe bariu; gëzohu, o oborr dhensh të arsyeshëm.

Gëzohu, o mbrojtëse kundër armiqsh të padukshëm; gëzohu, o hapëse e dyerve të Parajsës.

Gëzohu, se qielloret gëzohen bashkë me tokën; gëzohu, se tokësoret vallëzojnë bashkë me qiejt.

Gëzohu, o gojë e paheshtur e Apostujve; gëzohu, o guxim i pamposhtur i Athloforëve.

Gëzohu, o mbështetje e fortë e besimit; gëzohu, o njohëse e shkëlqyer e hirit.

Gëzohu Ti, me anën e së cilës u zhvesh Ferri; gëzohu Ti, me anën e së cilës u veshëm me lavdi.

Gëzohu o Nuse e panusëruar.

Duke parë Yllin Hyjrendës, Magët i ranë pas dritës së tij; dhe duke e mbajtur si kandil, kërkonin me të mbretin e fortë; dhe duke e arritur të paarritshmin, u gëzuan, duke i thirrur:

Alilua.

Bijtë e Kaldejeve panë në duart e Virgjëreshës atë që gatoi me dorë njerëzit; dhe duke e njohur për Zot, megjithëse mori formë shërbëtori, vrapuan ta adhurojnë nëpërmjet dhuratave, e t'i thërrasin të Bekuarës:

Gëzohu, o nënë ylli të paperëndueshëm; gëzohu, o agim dite mistike.

Gëzohu Ti, që shove furrën e gënjeshtres; gëzohu Ti, që ndriçon ata që hyjnë në të fshehtat e Trinisë.

Gëzohu Ti, që nxorre nga fuqia tiranin çnjerëzor; gëzohu Ti, që tregove Krishtin, Zot njeridashës.

Gëzohu Ti, që shpërblen nga feja barbarë; gëzohu Ti, që shpëton nga balta e veprave.

Gëzohu Ti, që pushove adhurimin e zjarrit; gëzohu Ti, që çliron nga zjarri i pasioneve.

Gëzohu, o udhëheqëse e urtësisë së besimtarëve; gëzohu, o dëfrim i gjithë brezave.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

Magët, duke u bërë predikues hyjprurës, u kthyen në Babilonë, duke kryer profecinë tënde e duke të predikuar ty, Krishtin, tek të gjithë, duke lënë si të marrë Irodhin që s' dinte të këndojë:

Alilua.

Duke ndritur në Egjipt ndriçim të vërtetë, dëbove errësirën e gënjeshtërs; se idhujt e saj, o Shpëtimtar, ranë ngaqë nuk duruan fuqinë tënde; dhe ata që shpëtuan prej tyre, i thërritnin Hyjlindëses:

Gëzohu, o ringritje e njerëzve; gëzohu, o rënie e demonëve.

Gëzohu Ti, që shkele mashtrimin e gënjeshtërs; gëzohu Ti, që demaskove dinakërin e idhujve.

Gëzohu, o det, që përmbyste Faraonin mendor; gëzohu, o shkëmb, që ujite të eturit për jetë.

Gëzohu, o shtyllë e zjarrtë, që udhëheq ata që ndodhen në Gërrësirë; gëzohu, o strehë e botës, më e gjerë se një re.

Gëzohu, o ushqim, pasardhës i mannës; gëzohu, o shërbyese dëfrimi të shenjtë.

Gezohu, o toka e premtimit; gëzohu Ti, prej së cilës rrjedh mjaltë dhe qumësht.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

Kur Simeoni do të ikte nga jeta e tanishme mashtruese, iu dhe në duar si foshnjë, por u njohe prej tij si Perëndi i përkryer; prandaj u çudit për urtësinë tënde të pashprehur, duke i thirrur:

Alilua.

STANCA E TRETË

Në të Premten e tretë të Kreshmëve në mbrëmje celebrohet Pasdarka e Vogël. Pas “Ti Meriton” psalet Kanoni i Hyj lindëses dhe Shkurtorja “Përlufteshës Gjenerale”. Në vijim prifti lëçit Stancën e Tretë të “Përshëndetjeve”.

Krijesë të re na tregoi Krijuesi, ne që u krijuam prej tij; duke lindur prej barku të pafarë dhe duke e raajtur ashtu siç ishte të pacënuar; që, duke parë çudinë, ta himnojmë, duke thirrur:

Gëzohu, o lule e paprishjes; gëzohu, o kurorë e vetëpërmbajtjes.

Gëzohu Ti, që shkëlqen tipin e ngjalljes; gëzohu Ti, që tregon jetën e Engjëjve.

Gëzohu, o pemë me frut të shkëlqyera, prej së cilës ushqehen besimtarët; gëzohu, o dru me gjethe që bëjnë hije të mirë, nën të cilën shumë vetë strehohen.

Gëzohu Ti, që linde udhëheqës për të humburit; gëzohu Ti, që linde shpërblyes për robërit.

Gëzohu, o zbutja e gjykatësit të drejtë; gëzohu, o falja e shumë fajtorëve.

Gëzohu, o veshje nga guximi i të zhveshurve; gëzohu, o dashuri që tejkalon çdo mall.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

Duke parë lindje të çuditshme, le të bëhemi të huaj për botën, duke transferuar mendjen në qiell; se prandaj Perëndia i Lartë u shfaq mbi tokë si njeri i përulët duke dashur të tërheqë tek lartësia ata që i thërrasin:

Alilua.

Itëri ishte në të poshtmet, dhe nga të sipërmet s' u largua fare Fjala e papërshkrueshme; sepse u bë denjim hyjnor dhe jo lëvizje vendore; dhe lindje me Shpirt Perëndie prej Virgjëreshe, e cila dëgjon këto:

Gëzohu, o vend i Perëndisë së panxënshëm; gëzohu, o derë misteri të nderuar.

Gëzohu, o dëgjim i dyshimtë për të pabesët; gëzohu, o mburrje e padyshimtë për besimtarët.

Gëzohu, o qerre e tërëshenjtë e atij që rri mbi Keruvimet; gëzohu, o shtëpi e mirë shumë e atij që rri mbi Serafimet.

Gëzohu ti, që i bashkove në një të kundërtat; gëzohu ti, që lidhe virgjëri dhe lehoni.

Gëzohu ti, me anën e së cilës u zgjidh shkelja; gëzohu ti, me anën e së cilës u hap Parajsa.

Gëzohu, o çelës i mbretërisë së Krishtit; gëzohu, o shpresë e të mirave të përjetshme.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

Tërë natyra e engjëjve u çudit për veprën e madhe të njerëzimit tënd; se shikonte të paafrueshmin Perëndi si njeri të afrueshëm për të gjithë, që rronte bashkë me ne dhe që dëgjon prej të gjithëve kështu:

Aliluia.

Oratorë shumëfolës i shohim si peshq të heshtur mbi Ty, o Hyjlindëse; se nuk dinë të thonë se si edhe Virgjëreshë mbetesh, edhe të lindësh munde; por ne, duke admiruar misterin, me besim thërrasim:

Gëzohu, o enë e urtësisë së Perëndisë; gëzohu, o arkë e providencës së Tij.

Gëzohu Ti, që i tregon filozofët të paditur; gëzohu Ti, që demaskon mjeshtërit e fjalës të paarsyeshëm.

Gëzohu, se u marrosën biseduesit e fortë; gëzohu, se u fishkën autorët e miteve.

Gëzohu Ti, që thyen thurjet e athinianëve; gëzohu Ti, që mbush rrjetat e peshkatarëve.

Gëzohu Ti, që nxjerr nga thellësia e padijes; gëzohu Ti, që ndriçon shumë vetë në dije.

Gëzohu, o anije e atyre që duan të shpëtojnë; gëzohu, o liman i atyre që lundrojnë në jetë.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

Duke dashur të shpëtojë botën, Bërësi i gjithçkaje erdhi tek ajo i vetëftuar; dhe duke qenë bari si Perëndia, për ne u shfaq njeri sipas nesh; se duke ftuar i ngjashmi të ngjashmin, dëgjon si Perëndi:

Alilua.

STANCA E KATËRT

Në të Premten e katërt të Kreshmëve në mbrëmje celebrohet Pasdarka e Vogël. Pas “Ti Meriton” psalet Kanoni i Hyjlindëses dhe Shkurtorja “Përlufteshës Gjenerale”. Në vijim prifti lëçit Stancën e Katërt të “Përshëndetjeve”.

Kështjellë e virgjëreshave je, o Hyjlindëse Virgjëreshë, dhe ke gjithë atyre që përikin tek Ti; se Ai që bëri qiellin dhe tokën të bëri, o e Kulluar, duke banuar në mitrën tënde dhe duke i mësuar të gjithë të të thërrasin:

Gëzohu, o shtyllë e virgjërisë; gëzohu, o portë e shpëtimit.

Gëzohu, o kryetare e rigatimit mendor; gëzohu, o dhënëse e mirësisë hyjnore.

Gëzohu, se Ti rilinde ata që u ngjizën turpërisht; gëzohu, se Ti urtësove të plaçkiturit në mendjen.

Gëzohu Ti, që shfuqizove prishësin e mendjeve; gëzohu Ti, që linde mbjellësin e dëlirësisë.

Gëzohu, o thalam nusërimi të pafarshëm; gëzohu Ti, që lidh besimtarët me Zotin.

Gëzohu, o rritëse e mirë e virgjëreshave; gëzohu, o nusestolisëse e shpirtrave të shenjtë.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

Cdo himn mposhtet kur përpiqet të zgjerohet sipas shumicës së mëshirave të tua të shumta; se, edhe në të blatofshim këngë aq sa rërë, o Mbret i shenjtë, nuk bëjmë asgjë të barazvlefshme për sa na ke dhënë neve që të thërrasim:

Alilulia.

Lambadhe dritëpritëse, që u shfaq për ata që ndodhen në Lerrësirë, e shohim Virgjëreshën e shenjtë; se, duke ndezur dritën e palëndshme, i udhëheq të gjithë në dijen hyjnore, duke ndriçuar mendjen me agim dhe duke u nderuar me thirrje si këto:

Gëzohu, o rreze e Diellit mendor; gëzohu, o shigjetë e dritës së paperëndueshme.

Gëzohu, o vetëtimë që shkëlqen shpirtrat; gëzohu Ti, që çudit armiqtë si gjëxim.

Gëzohu, se lind ndriçimin e shumëdritshëm; gëzohu, se buron lumin e shumëvalshëm.

Gëzohu Ti, që pikturon tipin e kolivithrës; gëzohu Ti, që heq njollën e mëkatit.

Gëzohu, vaskë që shplan ndërgjegjen; gëzohu, o krater që qeras ngazëllim.

Gëzohu, o aromë e erës së mirë të Krishtit; gëzohu, o jetë dëfrimi mistik.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

Detyrimet e vjetra duke dashur të falë, borxh-shlyesi i gjithë njerëzve, erdhi me anën e vetes së tij tek ata që u larguan nga hiri i tij; dhe duke grisur dorëshkrimin, dëgjon prej të gjithëve kështu:

Aliluia.

Duke kënduar lindjen tënde, të përhimnojmë të gjithë si tempull i shpirtshëm, o Hyjlindëse; se duke banuar në barkun tënd Zoti që i mban të gjitha në dorë, shenjtëroi, lavdëroi, dhe i mësoi të gjithë të të thërrasin:

Gëzohu, o tendë e Perëndisë dhe e Fjalës; gëzohu, o e Shenjtë, më e madhe se shenjtoret.

Gëzohu, o arkë e larë me ar prej Shpirtit; gëzohu, o thesar i pashpenzuar i jetës.

Gëzohu, o kurorë e çmueshme e mbretërve shpresëtarë; gëzohu, o mburrje e nderuar e priftërinjve të devotshëm.

Gëzohu, o fortesë e patundur e Kishës; gëzohu, o kështjellë e papushtueshme e mbretërisë.

Gëzohu Ti, me anën e së cilës ngrihen trofera; gëzohu Ti, me anën e së cilës rrëzohen armiqtë.

Gëzohu, o shërim i lëkurës sime; gëzohu, o shpëtim i shpirtit tim.

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

O Nënë e tërëhimnuar, që linde Fjalën, më të shenjtë se gjithë shenjtorët (3 herë); duke pritur blatën e tanishme, shpëtoi të gjithë nga çdo fatkeqësi dhe shpërblei prej Skëterrës së ardhshme ata që thërrasin bashkë:

Aliluia.

Tingull. T.IV.

Ti ipermaho stratigo.

Përlufteshës gjenerale këngët mundëse, si përhirim që e shpëtove prej tmerreve, qyteti yt po të përshkruan, o Virgjëreshë. Po sikurse ke fuqi të paluftuarshme, prej çfarëdo rreziku shpëtomë, se po të thërres:

Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

Lexuesi: Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishëm, Shenjt i pavdekshëm, mëshirona. (3 herë)

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Trini e Tërëshenjtë, mëshirona; o Zot, falna mëkatet tona; o Zot i madh, ndjei paudhësitë tona; o i Shenjtë, vështro dhe shëro sëmundjet tona, për emrin tënd.

Mëshiro, o Zot (*3 herë*).

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Ati ynë që je në qiejt, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote si në qiell ashtu edhe mbi dhe. Bukën tonë të përditëshme jepna neve sot; dhe falna fajet tona, sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë; dhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

Prifti: Se jotja është mbretëria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit, e Birit dhe e Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Lexuesi: Amin.

Përlufteshës gjenerale këngët mundëse, si përhirim që e shpëtove prej tmerreve, qyteti yt po të përshkruan, o Virgjëreshë. Po sikurse ke fuqi të paluftuarshme, prej çfarëdo rreziku shpëtomë, se po të thërres: Gëzohu, o Nuse e panusëruar.

Mëshiro, o Zot. (*40 herë*)

OKrisht, Perëndi që adhurohesh e lavdërohesh në çdo kohë e në çdo orë në qiell e mbi dhe, zemërgjerë,

zemërdhembshur, mëshirëplotë, që do të drejtët dhe mëshiron mëkatarët, që i thërret të gjithë në shpëtim me zotimin e të mirave të pritme, ti o Zot, prit lutjet tona në këtë orë dhe drejto jetesën tonë sipas porosive të tua. Shenjtërona shpirtrat, pastrona trupat, ndreqna mendimet, pastrona mendjet dhe shpëtona prej çdo hidhërimi, të keqeje dhe helmi. Mbrona me engjëjt e tu të shenjtë që duke u ruajtur dhe duke u udhëhequr prej ushtrisë së tyre të arrijmë të baresim tek bashkimi i besës dhe tek njohja e lavdisë sate të paafruar, se i bekuar je në jetë të jetëve. Amin.

Mëshiro, o Zot. (3 herë)

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Më të nderuarën se Keruvimet dhe më të lavdëruarën pa krahasim se Serafimet, që pa u cënuar linde fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindëse, ty të madhërojmë.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot. (3 herë). Beko, o Atë me emrin e Zotit.

Prifti: Perëndia na mëshiroftë dhe na bekoftë, na tregoftë dritën e fytyrës së vetë dhe na shpëtoftë.

Lexuesi: Amin. Mëshiro, o Zot. (3 herë)

Urata e të Tërëshenjtës

Prej Pavlit, murgut të Manastirit të Evergjetit.

E papikëlluar, e papërlyer, e pacënuar, e panjollshme, Virgjëreshë e pastër, Zonjë Nuse e Perëndisë, që bashkove Fjalën Perëndi me njerëzit me lindjen tënde të çuditshme dhe mbështete natyrën e hedhur të gjinisë sonë me qielloret; e vetmja shpresë e të dëshpëruarve dhe ndihma e të luftuarve; përkrahja e gatshme e atyre që rendin tek ti dhe strehë e gjithë të krishterëve; mos të ardhte ndot nga unë mëkatarin, i mallkuari, që prisha tërë veten time me mendime, fjalë dhe vepra të turpshme dhe që u bëra rob me dashje nga plogështia mendore e dëfrimeve të jetës; por si Nënë e Perëndisë njeridashës, me dashamirësi le të të vijë keq për mua mëkatarin dhe plangprishësin, dhe prit lutjen që të blatohet prej buzësh të ndotura; dhe lutju Birit tënd dhe mbretit e Zotit tonë, duke përdorur guximin tënd prej nëne që të ma hapë dhe mua zemrën njeridashëse të mirësisë së tij; dhe, duke mos vënë re fajet e mia të panumërta, të më kthejë në pendim dhe të më bëjë punëtor të sprovuar të porosive të tij. Dhe ji pranë meje gjithnjë, si mëshirëplotë, simpatike, dhe mirë-dashëse; në këtë jetë mbrojtëse dhe ndihmëse e nxehtë, duke thyer sulmet e kundërshtarëve dhe duke më udhëhequr drejt shpëtimit; dhe në kohë të ikjes sime, duke u kujdesur për shpirtin tim të mjerë dhe duke dëbuar larg faqet e errëta të demonëve të ligj; dhe në ditën e frikshme të gjyqit shpëtomë nga Ferri i amëshuar dhe tregomë trashëgimtar të lavdisë së patregueshme të Birit tënd dhe Perëndisë tonë; të Cilin e paça, o Zonja ime, Hyjlindëse e Përmbishenjtë, me ndërmjetimin dhe përkrahjen tënde me hirin dhe njeridashjen e Birit tënd të vetëmlindur, Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Jisu Krishtit; të Cilit i përket çdo lavdi, nder e adhurim, bashkë me Atin e tij të pafillim dhe Shpirtin e

tij të Tërëshenjtë, të mirë e jetëbërës, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Urata e Krishtit

Prej Antiokut, murgut të Pandektit.

Dhe jepna, o Zot, neve që shkojmë për gjumë, prehje trupi dhe shpirti: dhe ruajna nga gjumi i errët i mëkatit dhe prej çdo dëshire të errët e të natshme. Pusho hovet e pasioneve, shuaji shigjetat e zjarra të të ligut që lëvizin kundër nesh dinakërisht; thyaji kryengritjet e trupit tonë dhe vër në gjumë çdo mendim tokësor e lëndor. Dhe dhurona, o Perëndi, mendje vigjëluese, mendim të urtë, zemër esëll, gjumë të lehtë dhe pa ndonjë fantazi satanike. Dhe zgjona në kohë të faljes, të mbështetur në porositë e tua duke pasur me veten tonë kujtimin e pathyer të gjykimeve të tua. Falna lavdërimin tënd tërë natën, që të himnojmë, të bekojmë e të lavdërojmë emrin tënd të gjithënderuar e madhështor, të Atit e të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Epërmbilavdëruar, gjithmonëvirgjër, e bekuar Hyjlindëse, dërgoja faljen tonë Birit tënd dhe Perëndisë tonë dhe lypi që të shpëtojë me anën tënde shpirtrat tanë.

Shpresa ime është Ati; streha ime është Biri; mbrojtja ime është Shpirt i Shenjtë; Trini e Shenjtë, lavdi më Ty.

Gjithë shpresën time e vë tek ti o nënë e Perëndisë; ruajmë nën mbrojtjen tënde.

Prifti: Lavdi më Ty, o Krisht Perëndi, shpresa jonë, lavdi më Ty.

Lexuesi: Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin. Mëshiro, o Zot. (*3 herë*)
Beko, o Atë i shenjtë.

Prifti: Krishti Perëndia ynë i vërtetë, me ndërmjetimet e Nënës së Tij të pacënuar dhe krejt të papërlyer, të nderuarit, të lavdëruarit Profet, Pararendësit dhe Pagëzorit Joan; të Apostujve të shenjtë, të lavdëruar e të dëgjuar; të Martirëve të shenjtë, të lavdëruar dhe mundës të shkëlqyer; të Etërve tanë oshënarë dhe hyjprurës; (*të shenjtit të Kishës*) të Hyjprindërve të shenjtë e të drejtë Joakim dhe Ana, të shenjtit (*të ditës*) që lusim sot dhe të gjithë shenjtorëve, na mëshiroftë dhe na shpëtoftë si Perëndi i mirë, njeridashës dhe mëshirues.

Prifti: Le të lutemi për paqen e botës.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për të krishterët besëmirë dhe orthodhoksë.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për Kryepiskopin tonë (*aksh*) dhe për tërë vëllazërinë tonë më Krishtin.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për etërit dhe vëllezërit tanë të jetëndërruar.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për ata që na shërbejnë dhe për ata që na kanë shërbyer.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për ata që na urrejnë dhe për ata që na duan.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për ata që na porositën ne të pavyerit të lutemi për ta.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për çlirimin e robërve.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për mirëlundronjësit e deteve.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për të dergjurit në sëmundje.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për plotësinë e pemëve të dheut.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot.

Prifti: Për të gjithë të krishterët orthodhoksë, që prehen me shpresë këtu e kudo.

Lexuesi: I përjetshëm qoftë kujtimi i tyre.

Prifti: Le të themi dhe për veten tonë.

Lexuesi: Mëshiro, o Zot. (3 herë)

Tingull. III. **Tin Oreotita.**

O bukuri me nam, o virgjëri pa cen, o drit' e diellit, o hën' e qiellit. Shën Gavrili kur të pa, çuditej dhe të thërriste: Si të të lavdëroj, o Mari Hyjlindëse. Ç'këngë të këndoj për Ty, nuk e di dhe kërkoj më kot. Pra them sikundër jam porositur: Gëzohu, Virgjëreshë Hirplotë.

Prifti: Me uratat e Etërve tanë të shenjtë, o Zot Jisu Krisht Perëndi, mëshirona dhe shpëtona.

Psaltët: Amin.

Gjatë katër të premtëve të para të Kreshmës së Madhe, lexohet nga një stancë e “Përshëndetjeve”, ndërsa të premtën e pestë lexohen të gjitha.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Llukani, Andrea

/Himni Akathist

Andrea Llukani, Tiranë:

Botimet “Trifon Xhagjika”, 2016

48 f, 20 cm.

ISBN

